

## PROVIMI I MATURES SHTETËRORE 2017

### SESIONI I

#### SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

#### VARIANTI A

#### Lënda: Letërsi e thelluar

*Udhëzime të përgjithshme:*

- Testi përbëhet nga dy pjesë.
- Testi përmban një total prej 40 pikësh.
- Testi ka 20 pyetje. 10 me zgjedhje dhe 10 me zhvillim.
- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me 1 pikë.
- Për pyetjet me zhvillim përgjigjet konsiderohen orientuese dhe në skemë parashikohen variantet e mundësive të përgjigjeve të nxënësve.

#### PJESA I

Shekspir *Jul Cezari (Akti III, Skena I)*

|          |   |        |
|----------|---|--------|
| Pyetja 1 | A | 1 pikë |
| Pyetja 2 | C | 1 pikë |
| Pyetja 3 | C | 1 pikë |
| Pyetja 4 | D | 1 pikë |
| Pyetja 5 | B | 1 pikë |

#### Pyetja 6                  2 pikë

➤ Kahet e kontrastit:

*I lartë- poshtë u shtrive  
I lartë – Në kaqë pak t'u shtrydhe*

➤ Funksioni

- Kontrasti thekson kundërvënien midis çfarë ishte dhe përfaqësonce Cezari dikur dhe si është tani, i vrarë pabesisht dhe i shtrirë pa lavdi.

**OSE**

- Thekson tragjizmin e figurës së Cezarit: sa madhështor dikur dhe tani vrarë pabesisht dhe flakur përdhe pa lavdi.

**1 pikë** Nëse identifikon dy kahet e kontrastit.

**DHE**

**1 pikë** Nëse shpjegon funksionin që ai luan.

**0 pikë** Nëse përgjigja e dhënë nuk i përmbahet thelbit të pyetjes ose nuk ka përgjigje.

*Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përbën modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

---

**Pyetja 7****2 pikë**

➤ **Interpretim i plotë**

- Në lexim të parë duket sikur Mark Antoni i pranon dhe i mbështet kundërshtarët e Cezarit. Ai e di se ai është një rrezik për Brutin dhe bashkëpunëtorët e tij dhe se ai duhet të hiqet sikur është në anën e tyre, me qëllim që të jetojë. Për këtë ai i siguron ata se kanë besimin e tij
- Në nëntekst, gjaku është vula e vrasjes dhe pavarësisht se ai bashkon duart me ta, kjo është momentale, ata tashmë janë të shënuar nga gjaku i derdhur. Gjaku në duart e Antonit, si ngjyrë e luftës, e shënjon atë si një instrument për t'u hakmarrë kundër vrasësve të Cezarit.

➤ **Interpretim i pjesshëm**

- Mark Antoni i pranon dhe i mbështet kundërshtarët e Cezarit.

**2 pikë** Nëse interpreton **në mënyrë të plotë** nëntekstin e veprimit të Mark Antonit.

**OSE**

**1 pikë** Nëse interpreton **në mënyrë të pjesshme** veprimin të Mark Antonit, duke e parë atë vetëm në kuptimin e drejtpërdrejtë.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përbën modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

---

## Pyetja 8                  3 pikë

### ➤ Analiza e plotë

- Mark Antoni tronditet kur sheh Cezarin e vrarë dhe të shtrirë, mbuluar nga gjaku. Pavarësish se ai përpinqet t'i fshehë ndjenjat e dëshpërimit, mërzisë, për të mos rënë në sy të komplotistëve, sërisht në fjalët e tij kuptojmë adhurimin për figurën e Cezarit. *Cezar i lartë! Kaq posht'u shtrive; Në kaqë pak t'u shtrydhë? Lamtumirë!*  
Ai e shpreh qartë se është gati të vdesë nga dora e tyre, por kjo të ndodhë pranë trupit të Cezarit. Fjalët që ai thotë te trupi i pajetë i Cezarit, mbartin një ton të rëndë, shpesh solemn, adhurues. Të gjitha këto na çojnë natyrshëm në mendimin se ai, pavarësish momentit, s'do t'i falë kurrë vrasësit.
- Antoni është mbështetës i frysës së Cezarit dhe vlerëson deri në adhurim Cezarin; është besnik i tij, një tipar ky që duket qartë në të gjithë replikën.  
Ai është i guximshëm dhe stoik përballë vdekjes: *se sikur të rroj dhe njëmijë vjet të tjera/ veten s'e gjej kaq gati që të vdes.* Madje ai do të vdesë nga dora e atyre që vranë Cezarin. Antoni vuani që për momentin duhet të bëjë paqe me ta: *E zë për dor' armiq't e tu të gjaktë.* Ai i konsideron ata gjakatarë, armiq. Të gjitha këto detaje janë tregues se Antoni nuk do ta fashitë hakmarrjen e tij.

### ➤ Analiza e pjesshme

- Antoni e donte shumë Cezarin dhe do të hakmerret kundër vrasësve të tij. Në të gjitha fjalët e tij ndihet adhurimi për të.

**2 pikë**        Nëse analizon **në mënyrë të plotë** pse Antoni mund të kthehet ë të ardhmen në një armik të Brutit.

**OSE**

**1 pikë**        Nëse analizon **në mënyrë të pjesshme** pse Antoni mund të kthehet ë të ardhmen në një armik të Brutit.

**DHE**

**1 pikë**        Nëse mendimin e mbështet me ilustrime nga fragmenti.

**0 pikë**        Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

## Pyetja 9 (a)                  2 pikë

### ➤ Mjetet e stilistikës:

- Epitete: *Qesár i lartë!; trim, dre.*
- Pasthirrma: *oh, është e drejtë;*
- Apostrofë: *Cezar i lartë; Më ndje Qesar!*
- Metaforat: *Ishte zemra jote (e botës); Ishe pyll' i këtij dreri*
- Krasimi: *si një dre ..*

**2 pikë**        Nëse identifikon dy mjete të stilistikës.

**OSE**

**1 pikë**        Nëse identifikon vetëm një mjet të stilistikës.

**0 pikë**        Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 9 (b) 1 pikë****➤ Imazhi:**

- Krijohet imazhi i një heroi të fuqishëm që tronditi botën, i bukur, i shkathët e i egër, i fuqishëm, si dreri, i vrarë me tradhti.

**1 pikë** Nëse tregon imazhin e krijuar.**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.**Pyetja 10 3 pikë****➤ Përgjigje e plotë**

- Herói tragjik në vepër është Bruti.

Ai është herói kryesor i saj, edhe pse vepra mban emrin e Cezarit. Tek ai përmblidhen të gjitha tiparet e heroit tragjik të Rilindjes evropiane: është herói që lufton në emër të idealeve të larta; në emër të së drejtës, edhe pse në kushte të pabarabarta me kundërshtarët e tij, të cilët do ta çojnë drejt vdekjes së pashmangshme; është herói që sakrifikon veten në shërbim të së drejtës dhe së vërtetës, duke qenë njëherazi herói humanist i kohës.

Ai zotëron cilësi të larta morale e shpirtërore: vret duke dashur, por jo për hakmarrje apo për urrejtje; ai është largpamës në raport me formën e sundimit. Mënyra se si i drejtohet Antonit në fragment, dëshmon për pjekurinë, butësinë, drejtësinë dhe zemërgjerësinë e tij.

**➤ Përgjigje e pjesshme**

- Herói tragjik është Bruti. Ai e vret në emër të idealeve ta larta.

**➤ Ilustrime**

- Antón, mos e kërkó vdekjen prej nesh. Shih zëmrat plot mëshirë, dhe mëshira; Për vojtjet e përgjithëshme të Romës etj.*

**2 pikë** Nëse interpreton **në mënyrë të plotë** se Bruti është herói që përfaqëson frymën humaniste në vepër.**OSE****1 pikë** Nëse interpreton **në mënyrë të pjesshme** se Bruti është herói tragjik që përfaqëson frymën humaniste në vepër**DHE****1 pikë** Nëse mendimin e mbështet me ilustrime nga fragmenti.**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

**Pyetja 11****6 pikë**

Për esenë do të ndiqen kriteret e mëposhtme:

**KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË****2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shkruan një ese, ku argumenton qëndrimin e vet se, cili tip personazhi ka ndikuar më shumë tek ata nga pikëpamja etike dhe estetike: ata heroikë apo të zakonshëm.
- përdor detaje mbështetëse të marra nga përvoja personale apo e të tjerëve;
- ka qartësi mendimi.

**KRITERI II: ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E ESESË****1 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- respekton elementet e strukturës së esesë:

hyrjen

zhvillimin

përfundimin

**KRITERI III: STILI DHE ORIGJINALITETI****1 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- përmes gjuhës që përdor, krijon një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë.
- shprehet me një gjuhë eseistike.
- ka fjalor të pasur.
- stil origjinal.

**KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE****2 pikë**

**(1 pikë sintaksa dhe 1 pikë drejtshkrimi)**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore.
- ndërton fjali që janë të sakta dhe të qarta.
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm.
- ka saktësi drejtshkrimore.

**PJESA II****Fishta                    Lahuta e Malcisë**

|                  |          |               |
|------------------|----------|---------------|
| <b>Pyetja 12</b> | <b>B</b> | <b>1 pikë</b> |
| <b>Pyetja 13</b> | <b>A</b> | <b>1 pikë</b> |
| <b>Pyetja 14</b> | <b>C</b> | <b>1 pikë</b> |
| <b>Pyetja 15</b> | <b>C</b> | <b>1 pikë</b> |
| <b>Pyetja 16</b> | <b>A</b> | <b>1 pikë</b> |

**Pyetja 17 (a)                    2 pikë**➤ **Momenti:**

*ku un marrë hijen e ndo'i vashe  
me ty shoqe ase kushrinë,  
t' mësojshem këputat si me nisë,  
si me qepë si me qindisë?*

➤ **Shpjegimi**

Autori zgjedh t'i shpalosë cilësitet e Tringës (vajzë punëtore) përmes fjalëve të Zanës së Madhe, gjatë vajtimit, në rikthimin e saj në të shkuarën.

**OSE**

Për Trinëgn dhe cilësitet e saj flet Zana e Madhe, një qenie mitologjike, që gjatë vajtimit kthehet në një figurë njerëzore (si nëna që vajton fëmijën që nuk e ka më).

**1 pikë**                Nëse zbulon momentin u shfaqen tiparet e Tringës.

**DHE**

**1 pikë**                Nëse shpjegon të veçantën e teknikës së rrëfimit.

**0 pikë**                Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 17 (b)                    2 pikë**➤ **Tiparet e Zanës së Madhe:**

Tipare njerëzore: vajton pranë të vdekurit, qepte dhe qëndiste me Tringën;  
Tipare tradicionale të grave shqiptare;  
Është e pushtetshme, magjike: lan me ujë akulli;  
E shkrirë me natyrën;  
Do lirinë e kombit.

**2 pikë**                Nëse identifikon dy tipare të Zanës së Madhe.

**OSE**

**1 pikë**                Nëse identifikon vetëm një tipar të Zanës së Madhe.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

## Pyetja 18 2 pikë

- Këngët e vajeve kanë këto pika takimi me fragmentin e dhënë nga Lahuta e Malcisë:
- Ato i këndohen njeriut të vdekur dhe janë një rit që ndiqet duke e vajtar të vdekurin në prani të tij, Në fragmentin e dhënë i këndohet Tringës së vdekur, trupi i së cilës ndodhet i pranishme përpara Zanës së Madhe;
- Në këngët e vajit nuk përmendet fjala vdekje, është tabu - e njëjtë situatë edhe këtu (*çili sytë, mos mbaj mëri, t'ka rënë një hije e rendë*);
- Në këngët e vajit renditen tiparet e të vdekurit, momentet më të spikatura të jetës së tij, si dhe kujtimet më të bukura me atë që s'është më- edhe në këtë fragment ndodh e njëjtë gjë;
- Në këngët e vajit përmasat e dhimbjes në këngët e vajit hiperbolizohen, duke bërë pjesë të vuajtjes shpirtërore edhe natyrën apo qeniet mitologjike- edhe në këtë fragment ndodh e njëjtë gjë.
- Pyetjet retorike sigurojnë një dialog imagjinar me të vdekurin për të ndarë dhimbjen me lexuesin;
- Epitetet e përdorura për të vdekurin zgjidhen nga më të bukurit e fondit të figuracionit popullor. Të tilla janë edhe epitetet metaforikë që përdoren për Tringën (*moj hajmalí, morí rrezja npér frangí drita e syvet*)
- Lloji i vargut 8- rrökësh në *Lahutën e Malcisë* është gjithashtu tipik edhe për vajet popullore.

**2 pikë** Nëse identifikon dy momente të tillë në fragmentin e dhënë.

### OSE

**1 pikë** Nëse identifikon vetëm një moment të tillë në fragmentin e dhënë

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

## Pyetja 19 3 pikë

- **Figura stilistike është similituda (ose thjesht krahasim):**

*si ajo hana përngjat hyllit,  
kur bân dielli me prendue.*

- **Imazhi**

- Në këtë krahasim përfshihen disa elementë të natyrës: hëna, ylli, dielli në perëndim, një natyrë në lëvizje, e ngërthyer në të gjithë elementët e saj.  
Imazhi është ngacmues: lidhet me perëndimin diellit dhe bukurinë e ndriçimin e yllit të natës.  
Nënteksti është i fuqishëm për nga organizimi i figurës: e vetmja dritë në errësirë është ylli (Tringa) dhe hëna që e rrëthon atë me dritëhinen e saj është Zana e Madhe. Të gjitha ngjyrat vijnë e përzihen natyrshëm, në këtë imazh pamor në lëvizje.

**1 pikë** Nëse identifikon figurën e stilistikës.

### DHE

**2 pikë** Nëse përshkruan **në mënyrë të plotë** imazhin e krijuar.

### OSE

**1 pikë** Nëse përshkruan **në mënyrë të pjesshme** imazhin e krijuar.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

**Pyetja 20****2 pikë****➤ Vargjet:**

- *mirë po e lâte / me ujë gurre e lot të syvet  
A s'po sheh kush âsht tue t'lá?...  
Âsht tue t'lá, moj, Zana e Madhe:*

*âsht tue t'lá me ujë prej akullit  
e me lot të syvet t'ballit*

me ta xanë zogun e verës;  
me ta xanë t'mjerin e vocërr,

**➤ Përsëritja e vargjeve lidhet me:**

- ngadalësimin e ritmit të veprimit, tipike kjo për eposet, në të cilët pasazhet lirike jo të shumta shoqërohen me rimarrje vargjesh në të njëjtën formë ose në formë të ngjashme.

**OSE**

- theksimin e mesazhit, në rastin konkret thekson kryerjen e ritit të larjes së të vdekurit, por jo vetëm kaq, ajo thekson shpalosjen e dhimbjes së pakufi të Zanës për vdekjen e Tringës.

**OSE**

- theksimin e veprimit të kapjes së zugut të verës për Tringën, por në këtë rast theksohet dhimbja që sjell robëria (i mjeri, i vocërr)

**1 pikë** Nëse identifikon një moment të përdorimit të përsëritjes.

**DHE**

**1 pikë** Nëse shpjegon funksionin e këtij përdorimi.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*